

POEZIA ELEKTRONIKE (E-POETRY) SI NJË HORIZONT I RI

Esma DODAJ¹

¹ Department of Literature, Faculty of History and Philology, University of Tirana

Abstrakt

Vitet e fundit ndikimi i teknologjisë i ka tejkaluar fushat shkencore, duke mbërritur edhe në shkencat humane. Kështu, edhe në letërsi kemi kaluar nga teksti tradicional tek e-teksti dhe letërsia elektronike, ku përfshihet edhe e-poezia ose poezia elektronike. Në këtë punim, ne jemi përpjekur të tregojmë se e-poezia është më shumë se thjesht një “objekt”, një medium dhe se nuk është një pasardhëse logjike “inferiore” e poezisë së shtypur, së cilës ia zbeh vlerat, por është një formë e re, shfaqja e së cilës e ndryshon dhe e zgjeron fushën poetike në tërësi, duke përfshirë edhe nënfushën e poezisë së shkruar që vjen pas revolucionit digjital.

Në pjesën e parë të punimit, jemi përpjekur t'i afrohem natyrës së saj dhe të tregojmë se çfarë është poezia elektronike dhe cilat janë llojet e saj, duke sqaruar se ajo nuk është pjesë e letërsisë që shkruhet për t'u shfaqur dhe lexuar me anë të teknologjisë, por është pjesë e letërsisë së krijuar nëpërmjet teknologjisë. Në pjesën e dytë jemi fokusuar te poezia elektronike si një praktikë e re letrare dhe kulturore, duke dhënë një interpretim më "progresiv" të asaj që ajo është dhe nuk është, nëpërmjet një kalimi nga një qasje ontologjike drejt një qasjeje më antropologjike. Kështu tregojmë se horizonti i ri i poezisë nuk nënkupton zgjedhje midis llojeve, aq më pak zëvendësime, por ndërthurje midis tyre, ndoshta edhe “bashkëjetesë”, secila me veçoritë e saj specifike, me mangësitë, teprimet apo mbivlerat e veta.

Fjalë kyçe: poezi elektronike, teknologji, formë, horizont, praktikë letrare, praktikë kulturore.

Poezia elektronike (e – poetry)

Poezia si zhanër ka ditur të mbijetojë dhe të përshtatet me rrethanat e saj historike qysh prej fillimit të ekzistencës së saj si poezi orale, e cila njihet ndryshe edhe si poezi formulatike e deri në shekullin e XXI-të si poezi elektronike. Kjo është një prej vlerave të saj unike për të cilën dakordësohemi të gjithë. Me poezi orale kemi parasysh poezinë rituale (ninulla, lavde), lirike (kryesisht këngë për dashurinë) dhe narrative (epi, balada). Origjina e saj është ajo e vetë poezisë dhe fillimet duhet të kërkohen në ritual. Ndërsa me poezi elektronike (e – poetry), e cila njihet ndryshe edhe si poezi digjitale, kemi parasysh “aktivitetin krijues të poetëve që përdorin kompjuterat personalë si platforma për kompozime për formatin digjital.”⁶⁴

Ndoshta mund të flasim për një lloj origjine të hershme të saj duke pasur parasysh traditën e përkimit të imazhit me tekstin në poezi, të cilën e shfrytëzuan edhe poetët aleksandrinë. Shkrija e vizuales/vizualitetit dhe të të shkruarit ka ekzistuar gjithmonë.

⁶⁴ Letërsi ab-initio, Edlira Tonuzi, Albas, Tiranë, fq. 329

“Kaligramet e para të njohura janë treshja: “The hatchet”, “The wings” and “The egg”, të krijuara nga poeti grek Simmias nga Rodosi rreth 300 vite para lindjes së Krishtit. Fjala kaligrafi vjen nga fjalët greke “kallos”, që do të thotë "bukuri", dhe “graphos”, që do të thotë "shkrim", kështu që kaligrami ka të bëjë me artin pamor që thekson bukurinë e shenjës së shkruar.”⁶⁵ Në Mesjetë ajo u lidh më shumë me procesin e dekorimit. Ky raport midis vizuales dhe shkrimit (një aspekt normal në traditën orientale) ka vazhduar për shumë shekuj edhe në kulturën perëndimore, ndonëse në epokën e Gutenbergut, gjërat ndryshuan për shkak të mediumit të ri.

“Është Stephan Mallarmé, me të famshmen e tij “Un coup de dés jamais n'abolira le hazard” botuar në 1897, i cili gjurmon një ndryshim në eksperimentet poetike. Teksti bëhet menjëherë një imazh. Sa i përket dimensionit vizual, teksti ndjek një "sintaksë" të re, duke përdorur, për shembull, shkronja të mëdha ose të vogla. Heshtja futet në rrugën e leximit me anë të hapësirës.”⁶⁶ Në këtë linjë të refuzimit të rregullsisë së imponuar nga tipografia dhe përfitimit prej elementeve të tjerë të shenjave, boshllëqeve, ngjyrave, imazheve, parregullsisë, përmbysjeve, etj., gjejmë edhe Kaligramet e Apollinaire-it, poezinë vizuale të shekullit të XX-ë, futurizmin, kubo-futurizmin, dadaizmin, surrealizmin, lettrizmin, poezinë pamore dhe konkrete, poezinë e zërit, etj., kur prodhimet poetike shfrytëzuan zhvillimet teknologjike të fundit dhe përdorën pajisjet e tij të reja si: disku, shiriti magnetik, kaseta audio, pastaj video ose CD-ROM, etj.

Mirëpo, poezia e njëmendtë elektronike e krijuar nga kompjuteri lindi në vitin 1959 në Shtutgart, kur gjermani Theo Lutz, nën sugjerimin e Max Bense-it, arriti të prodhonte vargjet e para elektronike pa pagesë, duke përdorur një makineri që ende quhej "kalkulator" dhe jo kompjuter. Pothuajse njëkohësisht, Brion Gysin-i që në gjendje ta bënte të njëjtën gjë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Falë evolucionit në teknologji, në vitet e tjera në vijim filluan eksperimentet e poezisë elektronike edhe në Kanada e Francë, ku në vitin 1959, inxhinieri francez, François Le Lionnais, me sa duket e bindi Raymond Queneau-në për të themeluar "Séminaire de Littérature Expérimentale", që në 1960-ën do të ndryshohej në OuLipo-n e famshme, “Ouvroir de Littérature Potentielle”. E më vonë edhe në Itali (kujtojmë poemën “Tape Mark” nga Nanni Balestrini, të realizuar në vitin 1961 me një makinë llogaritëse IBM).

Kufijtë e poezisë elektronike nuk janë aspak të mprehtë, pjesërisht sepse ajo mbetet një formë emergjente, por edhe sepse iu mbivendoset ose ndërthuret me shumë forma të tjera të letërsisë dhe artit, si për shembull: fiksioni hipertekst, arti i bazuar në kohë, arti i instalimeve, arti rrjetë, poezia e performancës dhe poezia e tingujve, etj., si dhe me zhanret që nuk konsiderohen domosdoshmërisht art si: realiteti virtual, lojërat kompjuterike dhe MUD-s. Brenda fushës së procesit digjital, mund të ketë debat rreth asaj që ne zgjedhim të quajmë letërsi elektronike dhe më pas, brenda fushës së letërsisë elektronike, ka pyetje të mëtejshme rreth asaj që ne zgjedhim të quajmë poezi dhe se çfarë është poezia digjitale.

Por mund të themi se ekziston njëfarë marrëveshjeje e përgjithshme, se poezia digjitale nuk është thjesht poezi tekstuale e shpërndarë në web ose e vendosur në formë elektronike. Ajo i përdor vetitë e mediumit digjital në një mënyrë kuptimplotë dhe të dallueshme. Norbert Bachleitner-i ofron një përkufizim disi të lirë të poezisë digjitale, si “vepra novatore me cilësi specifike që nuk mund të shfaqen në letër”. Ne do ta përcaktonim si një poezi, forma e së cilës varet tërësisht nga funksionimi i proceseve digjitale në një pajisje elektronike dhe që ka cilësi poetike të pasurisë semantike dhe të formës kuptimplotë. Një debat i madh në kritikën dhe pranimin e poezisë digjitale sillet rreth çështjes së “ririsë” së saj dhe në veçanti rreth faktit nëse ajo kërkon terminologji kritike krejtësisht të re.

⁶⁵ <https://journals.openedition.org/carnets/3762?lang=en>

⁶⁶ Po aty.

Katherine Hayles-i, studiuesja më e shquar e letërsisë elektronike, argumenton fuqishëm për ndryshimin rrënjësor që ajo mbart në vetvete, duke argumentuar se "letërsia elektronike funksionon në mënyra thelbësisht të ndryshme prej asaj të shtypurës dhe kërkon korniza të reja kritike për të vlerësuar praktikën e saj të leximit dhe shkrimit". Të tjerë, si Glazier-i, i kushtojnë rëndësi poezisë digjitale më shumë si një zgjatim i traditave poetike të teksteve novatore të shekullit të XX-të. Në secilën qasje ka "rreziqe", siç identifikohet edhe nga Espen Aarseth-i: nga njëra anë, rreziku i aplikimit të koncepteve letrare kritike/teorike në mënyrë jorefektive, duke bërë që ato të kthehen në "metafora të pafokusuara"; nga ana tjetër rreziku i "determinizmit teknologjik", duke supozuar se teknologjia materiale e përfshirë në poezinë digjitale përcakton atributet e saj dhe e bën atë rrënjësisht të re.

Në këtë pjesë do të paraqesim edhe tipologjitë e poezisë elektronike. Siç e dimë, ky term strehon forma të ndryshme të poezisë të krijuara nga mbështetja jonë digjitale nën ombrellën e saj: nga poezia hipertekstuale të instalacionet, nga poezia gjeneruese të poezia që ka imazhe dhe tinguj në tekst, nga poezia e animuar në video-poezi, etj. Edhe pse ndajnë të njëjtin medium digjital, spektri i mundësive është i gjerë. Sipas Loss Pequeño Glazier-it, hiperteksti, poezia vizuale/kinetike dhe punimet në median e programueshme janë tri format kryesore të tekstualitetit elektronik. Kjo tipologji është kategorizimi më i zakonshëm i e-poezisë, por është shumë i përgjithshëm dhe nuk i merr parasysh disa aspekte novatore të e-poezisë, megjithatë, shumë teoricienë e përdorin këtë tipologji për të përshkruar "nëngjinitë" e poezisë elektronike. Ndërsa si lloje të saj përmendim:

1. Poezia gjenerative (Lloji tradicional dhe ndoshta më i njohuri i e-poezisë, e cila prodhohet nga algoritmet programuese që krijojnë një performancë të paparashikuar poetike.)
2. Poezia kodike (Kjo poezi shkruhet njëkohësisht për kompjuterin dhe njeriun, të dy në rolin e marrësit, receptuesit.)
3. Poezia vizuale (Kjo poezi lind nga poezia vizuale konkrete dhe nga ajo letriste. Imazhet ndërveprojnë dhe/ose ndihmojnë për të deshifruar tekstin).
4. Poezia kinetike (Kjo poezi realizohet nëpërmjet aftësisë kompjuterike për të shfaqur animime dhe ndryshime informacioni gjatë gjithë kohës.)
5. Poezia multimediale (Kjo poezi ndërthur audio, video, imazhe, tekste, etj.)
6. Poezia interaktive (Kjo poezi ndërthur materiale nga lexuesi. Lexuesi merr pjesë në krijimin e tekstit.)
7. Poezia hipertekstuale (Ky lloj poezie e strukturon poezinë në hapësirën digjitale që do ta eksplorojë lexuesi nëpërmjet nënthurjeve/nyjave dhe linqeve.)
8. Poezia e sekuencës (Kjo poezi realizohet nëpërmjet fjalëve që duken e zhduken në ekran.)
9. Poezia elektronike dinamike/ose poezia flash (Aspekti i fortë është pikërisht dinamizmi i fjalëve dhe i imazheve. Për më tepër, dinamizmi është i nevojshëm për ndërtimin e kuptimit.)

Etj.

Në letërsinë elektronike flasim gjithashtu edhe për dramë interaktive.

Si përfaqësues të poezisë elektronike mund të përmendim Maria Mencia me "Vocales", Elisa Carlotti "La rossa parola", Rui Torres "Poemas no meio do caminho", Marie Belisle me "Alter Ego", Aya Carpinska, Eduardo Kac "Storm", Alex Gopher "The child", etj.

"Një horizont i ri"

Kur flitet për letërsinë bashkëkohore, pakkush e përmend letërsinë elektronike. Nëse arti bashkëkohor na lidh me multimedien, letërsia bashkëkohore në përgjithësi evokon vetëm prodhimin e fundit të botuesve tradicionalë. Filmi, radioja, televizioni dhe interneti kanë zhvilluar aftësitë e tyre të tregimit, poetikën e tyre, "gjuhën" e vet.

Këto elemente janë përdorur edhe prej poezisë digjitale dhe “gjuhës së saj të re”, sepse me teknologjitë e komunikimit dhe informacionit, TIK-un, si letërsia në përgjithësi, ashtu edhe poezia në veçanti u çliruan nga mediumi i letrës për të eksploruar mënyra të reja shprehjeje. Vitet e fundit poezia ka qenë objekt reflektimesh të thella dhe eksperimentesh të reja. Në e-poezi ka elemente strategjike të tilla si: infografikë, poetika e elementeve, (pa)lexueshmëria e tyre, shumëkuptimësia e relacionit imazh-tekst dhe rrjedha e procesit të leximit në rirregullimin tekstual, të cilat ndikojnë në strukturën e poezisë elektronike.

Ato krijojnë trope dhe figura të reja dhe rrjedhimisht, një sens të ri estetik. Të gjitha këto elemente përbërëse prodhojnë lloje të ndryshme praktikash krijimi dhe leximi, të cilat, nga njëra anë, duket se propozojnë një lloj qasjeje aktive dhe nganjëherë edhe lozonjare ndaj tekstit poetik, dhe nga ana tjetër sugjerojnë “korrupsionin” midis zhanreve, duke e shtyrë poezinë drejt web-artit dhe duke e lidhur fjalën letrare me Inteligjencën Artificiale (AI).

Mund të themi se në e-poezi, rolet e lexuesit dhe autorit janë ripërcaktuar (kemi parasysht rolet e tyre në poezinë "tradicionale"), për aq sa ndoshta në çdo lloj e-poezie ndodh një ose më shumë nga proceset e mëposhtme:

a) Përdoruesit duhet të ndërveprojnë me poezinë (në disa raste duhet të veprojnë në tekst që teksti të shfaqet.)

b) Ka forma të procedurave bashkëpunuese dhe/ose gjeneruese që e ndryshojnë rezultatin poetik.

c) Poezitë mund të jenë kalimtare.

d) Praktika e leximit mund t'i kujtojë lexuesit një lloj shkrimi përvojë (për shkak të disa veprimeve që lexuesi ka kryer/duhet të kryejë për ta lexuar tekstin.)

Etj.

Megjithatë, tekstet elektronike janë ende tekste, edhe pse parashtrajnë kësi karakteristikash të veçanta, të cilat, megjithatë, nuk janë krejtësisht të reja. Përmendim këtu teorinë e gjuhës si multimodalitet (sinkretizmi) ose multilinearitetin (bashkekzistenca e shtigjeve alternative). Edhe semiotika, në kuptimin e saj të gjerë, mund të jetë e dobishme në analizën e tekstit elektronik, sepse vetë semiotika ka ndryshuar për të marrë (dhe tani merr) parasysht “sfidën” nga sistemet e shenjave kibernetike.

Por si duhet t'i qasemi e-poezisë? Pranohet gjerësisht se e-poezia nuk është ose të paktën nuk supozohet të jetë, "poezi e digjitalizuar", domethënë, poezi e shtypur ose e shkruar me dorë dhe pastaj e transferuar në një mjedis digjital, por poezi e shkruar në mënyrë specifike për t'u lexuar në mediumet digjitale, pra nuk bëhet fjalë për një letërsi që shkruhet për t'u shfaqur dhe lexuar me mjete të teknologjisë, por për një letërsi të krijuar përmes teknologjisë. Megjithatë, në praktikë, gjërat nuk janë aq të qarta. Shumë e-poezi me siguri shkruhen fillimisht në letër dhe vetëm më pas përkthehen në mediumin e ri.

“Për më tepër, të menduarit tonë për e-poezinë bie në mënyrë të pashmangshme pre e asaj që Marshall McLuhan-i i referohej si shikimi i së tashmes përmes një "pasqyre të pamjes së pasme", domethënë kemi tendencën për ta interpretuar të renë në dritën e së vjetrës, "duke ecur prapa nga e ardhmja.”⁶⁷ Por ne mendojmë se është e domosdoshme të përiqemi të shpëtojmë nga ky vështrim retrospektiv mbi e-poezinë dhe të japim një interpretim më "progresiv" të asaj çfarë ajo është dhe nuk është.

Për këtë na duhet të mbajmë parasysht se e-poezia është ndërvepruese dhe lexuesi bëhet shkrimtar ose "shkrues"; se ajo është një formë e shkrimit multimedial; se është e lëvizshme, dinamike, multiformale, në disa raste edhe evaneshente dhe momentale, deri në atë masë sa që rileximi i një e-poezie bëhet edhe disi i pamundur. Këto elemente i gjejmë edhe te format e vjetra të poezisë.

⁶⁷ <https://journals.dartmouth.edu/cgi-bin/WebObjects/Journals.woa/xmlpage/4/article/288>

P.sh., mund të themi se tradita e lashtë e poezisë kombinuese ka parashikuar logjikën e bazës së të dhënave dhe traditën e shekullit të XX-ë të poezisë së kolazhit dhe mozaikut. Format e tjera kanë qenë kryesisht vizuale, si disa nga eksperimentet më radikale të e-poezisë sot, për shembull Rasula dhe McCaffery (1998). Edhe problemi i ruajtjes dhe evaneshencës nuk është aq i ri sa duket, pasi mund të vlejë edhe për letërsinë orale.

Kemi gjithashtu edhe çështjen e cilësisë dhe meritës, e cila është një tjetër gjë e diskutueshme. Disa teoricienë këmbëngulin në faktin se nuk mjafton të kesh lloje të reja shenjash (të lëvizshme, të vizualizuara fort, shenja ndërvepruese) dhe lloje të reja të medimeve pritëse (një ekran kompjuteri, një ekran projeksioni, një mjedis realiteti virtual). Në vend të kësaj, këto risi teknike duhet të shoqërohen nga lloje të reja të përmbajtjes, mundësisht të lidhura me veçoritë specifike të shenjave dhe mediumit në fjalë.

Dhe ne mendojmë se te e-poezia, mund t'i gjejmë këto. Për ne nuk ka rëndësi të demonstrojmë meritat apo anët pozitive të e-poezisë, as nuk duam të tregojmë se e-poezia është më interesante se sa besohet përgjithësisht. Ajo që është e nevojshme sipas nesh, është një qasje që tregon se e-poezia është ndryshe nga sa pritej. Në thelb, ajo që ne kërkojmë është një zhvendosje nga një qasje ontologjike në një lloj qasjeje më antropologjike. Në vend që të pyesim se çfarë është shkrimi i medimeve të reja ose më konkretisht e-poezia, duhet të shohim se si përdoret, si është ngulitur në praktikat letrare dhe kulturore. Në një farë kuptimi, ky është kalimi nga digjitalja te virtualja, pra nga themeli teknologjik në aplikimin dhe funksionin e tij kulturor. Kjo na çon në një lexim të orientuar më shumë drejt studimeve kulturore të asaj që nuk mund të trajtohet më vetëm si një çështje teknike ose formale. Një zhvendosje në një qëndrim kulturor nuk duhet të shihet domosdoshmërisht si një paradigmë e re.

Gjithashtu, digjitalizimi nuk e ka ndryshuar në mënyrë dramatike formën dhe përmbajtjen e poezisë, sidomos asaj avantgarde, (dhe nëse e ka ndryshuar, e ka bërë këtë në një masë shumë më të vogël nga sa besojmë përgjithësisht, sepse të gjitha imazhet sot janë bërë digjitale ose të paktën të digjitalizueshme), por ka revolucionarizuar mënyrën se si ne i lexojmë dhe ndoshta edhe i kritikojmë, analizojmë e studiojmë ato. Ajo që ndryshon rrënjësisht pra është përdorimi i tyre social. Sot, poezitë qarkullojnë më lehtë dhe më shpejt se kurrë; arrijnë një audiencë të gjerë jo më shumë se në një çast; mund të transferohen lehtësisht nga një pajisje në tjetrën.

Nga ky këndvështrim, ndryshimi është i konsiderueshëm, poezitë paradigjitale dhe poezitë digjitale mund të duken pak a shumë të njëjta, por përdorimet e tyre ndryshojnë ndjeshëm, kryesisht sepse ato digjitalët janë të hapura ndaj formave më të individualizuara të transformimit, qarkullimit dhe ripërdorimit, dhe prandaj janë më të hapura ndaj negociatave sociale. Por në tërësi, e-poezia dhe poezia e shtypur nuk duhet të shihen veçmas, pasi të dy llojet funksionojnë brenda rrjetit më të madh të poezisë bashkëkohore në tërësi.

E-poezia prodhon një marrëdhënie "të re" me tekstin, lexuesin dhe autorin. "Lexuesi" mund të vendosë të marrë pjesë në ndërtimin e poezisë dhe poezia na rezulton si një strukturë e hapur. Sipas Carlo Infante-s, shkrimi bashkëpunues në rrjet ushtron një ndjeshmëri të re: kalimin nga dimensionin shprehës në një kërkim të lidhur. Dhe ky është elementi i rëndësishëm: në shkrimet hipertekstuale (dhe gjithashtu në ato hipermediale dhe/ose gjeneruese), ne mbetemi gjithmonë brenda fushës së shprehjes, ndërsa me shkrimin bashkëpunues ka dukshëm një përparim, meqë përballemi me një të re shoqërore. Kështu ndryshon dhe paradigma e aktit të komunikimit: të jesh autor nuk është më gjëja më e rëndësishme; përkundrazi, shkrimi nuk zhvillohet më vertikalisht, por horizontalisht.

E-poezia nuk ecën kurrë e vetme në fushën kiberkulturore të letërsisë. Ajo shoqërohet nga një grup ose më mirë një tërësi performancash dhe është e integruar në një qark shpërndarjeje, digjital dhe jodigjital. Në këtë nivel, vetë dallimi midis poezisë dhe e-poezisë zbehet, pavarësisht nga veçoritë mesatare specifike të secilës prej këtyre praktikave. Artefaktet digjitale, edhe kur prodhohen për t'u "lexuar në ekran", nuk përdoren gjithmonë sipas qëllimit.

Një nga sfidat e papritura dhe për rrjedhojë edhe më të rëndësishmet për artin digjital, është thjesht ta bësh atë të funksionojë. Realiteti na ka mësuar të jemi të kujdesshëm. Në shumicën e rasteve, teknologjia nuk funksionon dhe funksionimi i saj korrekt kërkon shumë kohë, njerëz, energji dhe para. Takimi i krijuesit dhe i përdoruesit të një vepre të tillë nuk ndodh “në ekran apo në hapësirën kibernetike”, por është më shumë një performancë, duke përfshirë jo vetëm ndërveprimet e ndërmjetësuar nga makina të leximit dhe shkrimit, por edhe kontekstin më të gjerë kulturor të e-poezisë në veprim. Me tekstin bashkëpunues, shkrimtari bëhet ndërlidhja e dy praktikave: të të lexuarit dhe të të shkruarit. Kështu, autori i një vepre kolektive është në të vërtetë një projekt-krijues; ai/ajo propozon një projekt që ecën pikërisht falë “rishkrimit” të shkrimtarëve të tjerë. Kështu, puna është vërtet e hapur, por është një punë kalimtare. Në të vërtetë, arti rikrijues është një art i realitetit, i një realiteti në metamorfozë, një art i kombinuar në të tashmen: hic et nunc.

Kësisoj, koncepti i autorit ndryshon shumë: autori nuk është më një autor, por një autor i mundshëm teksti. Duket se materializohet ai lloj “dehumanizimi pozitiv i gjuhës” i kërkuar nga Balpe-ja, në të cilin elementi prioritar është teksti/shkrimi. Ky krijim mekanik duket se e “zhvlerëson” personin dhe në të njëjtën kohë “rivlerëson” (shkrimin). Deri kohët e fundit, shumica e studiuesve dhe kritikëve kanë theksuar domosdoshmërinë për t’i rimenduar nocionet bazë të tekstit, autorit, leximit, veprës, kuptimit, etj. në dritën e zhvendosjes globale nga kultura tradicionale e printimit në kulturën digjitale dhe ja ku e kemi një rimendim, një ridimensionim. Format i ri i e-poezisë nuk nënkupton më një zgjedhje midis kësaj apo asaj forme ose zëvendësim të një lloji të paraqitjes nga një tjetër, por futjen e poezisë në një grup dukurish që plotësojnë njëra-tjetrën, aq më tepër kur “distanca” midis poezisë së shtypur dhe e-poezisë po zvogëlohet, jo në kuptimin se veçoritë e tyre dalluese po shkrihen, por në kuptimin që tani të dyja janë pjesë e një tërësie më të madhe kiberkulturore.

Përhapja e e-poezisë përfaqëson një sfidë, por edhe një mundësi për poezinë e shtypur. Poezia e shtypur nuk është zhdukur aspak. Përkundrazi, përderisa poezia e shtypur po “kalon në poezi digjitale”, ne kemi gjithashtu poezi digjitale që po “shtypet”. Po ashtu, ajo pasqyron një mënyrë të menduarit me një retorikë të fortë të së ardhmes dhe më gjerë, dhe pranon faktin se poezia priret të jetë pjesë e rrjeteve me forma të shumta mediatike që banojnë rreth së njëjtës vepër. Në këtë mënyrë, veprat dhe mediumet nuk vazhdojnë të jenë ishuj, por vargje ose rrjete.

Përfundime

Poezia elektronike ofron një larmi shumë të ndryshme të poezive digjitale që kërkojnë praktika të ndryshme për t’iu afruar tekstit, praktika të ndryshme të "mendimit" e "leximit". Dhe ky punim është përpjekur të tregojë se si mund t’i qasemi atyre duke pasur parasysh pikërisht ato praktika si dhe marrëdhënien “e re” që ato krijojnë me tekstin, lexuesin dhe autorin.

Nëpërmjet e-poezisë mund të provohet një marrëdhënie më pak “serioze” me letërsinë, si një formë e performancës shoqërore. Nga ana tjetër, ajo ka rritur afinitetet e shumta që ekzistojnë midis fushës së e-poezisë në kuptimin e ngushtë të fjalës dhe asaj të poezisë në përgjithësi. Poezia elektronike nuk është një pasardhëse logjike e poezisë së shtypur, por një formë e re, dhe vetë pamja e saj ndryshon fushën poetike në tërësi, duke përfshirë edhe nënfushën e poezisë së shkruar që “vjen pas” revolucionit digjital.

Në forma të ndryshme, e-poezia propozon një eksperiment letrar “primitiv”, mbiemër në të cilin nuk duhet kërkuar asnjë konotacion negativ, por thjesht fakti se i referohet një kohe të mëparshme/më të hershme. Ashtu sikurse fëmijët luajnë me gjuhën para se të mësojnë të flasin, poezia elektronike luan me formën e saj për të krijuar përmbajtjen e saj, praktikë që nuk është e re për poezinë si gjini. Nëpërmjet poezisë digjitale, ne fillojmë të kemi sërish një marrëdhënie vizuale, materiale dhe ludike me gjuhën.

Për më tepër, në tekstin bashkëpunues dhe gjenerues lexuesi luan rolin e autorit, autori eksperimenton programimin ose ndan funksionin e tij/saj. Është e qartë se shkrimi bashkëpunues hap një problematikë në lidhje me autorësinë, por nga ana tjetër lejon një lidhje reale horizontale midis autorit dhe lexuesit. Së fundmi, letërsia elektronike teston kufijtë e letërsisë dhe na sfidon të rimendojmë supozimet tona rreth asaj se çfarë mund të bëjë dhe të jetë letërsia.

Referencat

1. Di Rosario Giovanna, "Electronic Poetry Understanding Poetry in the Digital Environment", JYVÄSKYLÄ STUDIES IN HUMANITIES 154, 2011
2. <https://electronicbookreview.com/essay/literary-texts-as-cognitive-assemblages-the-case-of-electronic-literature/>
3. <https://eliterature.org/>
4. <https://eliterature.org/pad/elp.html>
5. <https://journals.dartmouth.edu/cgi-bin/WebObjects/Journals.woa/xmlpage/4/article/288>
6. <https://journals.openedition.org/carnets/3762?lang=en>
7. <https://newhorizons.eliterature.org/essay.php?id=11.html>
8. <https://www.poetryfoundation.org/articles/69619/breaking-the-poetry-code>
9. Loss Pequeño Glazier Digital Poetics: The Making of E-Poetries, Alabama: University of Alabama Press, 2001
10. Macaj (Tonuzi) Edlira, "Letërsi-ab initio", "Albas", Tiranë, 2019